

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Lloga pas aktgjykimit të Hagës: Shfuqizimi i Gjykatës Speciale është thujse i pamundur
ADRESA	https://albeu.com/kosove/lloga-pas-aktgjykimit-te-hages-shfuqizimi-i-gjykates-speciale-e-shte-thujse-i-pamundur/1018665/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 12:07:01 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 12:04:42 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a8b8df598cd21a2e0744d098f2d60e919996f05ab336acf889039275d9a4c713
TEKSTI	7a302bbf3948a331d547d59b1555bba37669f69ab8d3945cca6f7073f81db18a
PAMJA	e55abf016a981dba3863f64ff599212a9221a0d2d4f24c60cca936ee9d6496e7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0bdebcd3f00aae2ec6fed6d650af845971487c3696394346a2afc369a9da08be
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	d62161966812e333892ed1a12b4b718f8d0962907bcb93c104eb3485a382e6f9
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0bdebcd3f00aae2ec6fed6d650af845971487c3696394346a2afc369a9da08be>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lloga pas aktgjykimit të Hagës: Shfuqizimi i Gjykatës Speciale është thuajse i pamundur



Krenar Lloga, ish-ministër i Drejtësisë në Maqedoninë e Veriut, ka bërë një analizë juridike mbi mënyrën se si u themeluan Dhomat e Specializuara dhe pengesat që do të paraqiteshin në rast të një nisme për shfuqizimin e tyre.

Sipas Llogës, aktgjykimi i shkallës së parë ka rikthyer në Kosovë dhe në hapësirat shqiptare diskutimet se si u krijuan Dhomat e Specializuara, kush i themeloi dhe nëse ato mund të zhbëhen. Ai vlerëson se, përpara qëndrimeve politike, duhet të analizohet baza kushtetuese e këtij institucioni.

Ai sqaron se Dhomat e Specializuara nuk u ngritën me një rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe as sipas modelit të ICTY-së. Ato u bënë pjesë e Kushtetutës së Republikës së Kosovës nëpërmjet votimit në Kuvendin e Kosovës.

Më 26 qershor 2015, amendamenti kushtetues për krijimin e Dhomave të Specializuara nuk arriti të sigurote votat e nevojshme. Në atë votim, 75 deputetë votuan pro, 7 kundër dhe 2 abstenuan. Çështja u hodh sërish në votim më 3 gusht 2015, kur u regjistruan 82 vota pro, 5 kundër dhe 1 abstenim.

Përmes Vendimit nr. 05-V-139 u miratua Amendamenti XXIV, ndërsa Kushtetutës iu shtua neni 162, i titulluar "Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar". Lloga thekson se pikërisht ky nen është themeli kushtetues mbi të cilin mbështetet institucioni.

Në analizën e tij, ish-ministri shpjegon se neni 144 i Kushtetutës nuk lejon që ndryshimet kushtetuese të miratohen vetëm me shumicë të zakonshme parlamentare. Për një amendament kërkohen njëkohësisht votat e dy të tretave të të gjithë deputetëve të Kuvendit, që nënkupton të paktën 80 nga 120, si dhe dy të tretat e deputetëve që kanë vende të garantuara për komunitetet joshumicë, përkatësisht së paku 14 nga 20. Kjo përfshin minimumi edhe votat e 4 deputetëve serbë.

të fundit /




Ndryshimet në qeveri, Berisha sulmon Ramën: Kontrollloi...



Vendim i papritur në Kategorinë e Parë, Oriku ndërpret...



Hansi Flick kërkon që Barcelona të ndjekë sulmuesin që po...



Prindërit akuzohen për vrasje pasi foshnja 3-muajshe humbi jetën...



Dinamo shpreh krenarinë për Naser Alijin, i vetmi lojtar ng...



Hekuran Kryeziu shpall listën e Kosovës U21 për tri ndeshjet e...



Krimi i rëndë në Tiranë/ Qëlloi për vdekje bashkëshorten,...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Lloga kujton se, pas kundërshtimit të votimit të vitit 2015, Gjykata Kushtetuese konstatoi se Amendamenti XXIV ishte miratuar në përputhje me shumicën e posaçme që kërkon neni 144(2). Për pasojë, Dhoma e Specializuar nuk u themeluan thjesht me 82 vota, por me shumicën e dyfishtë kushtetuese, në të cilën u përfshinë edhe përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë.

Kjo do të thotë se edhe një përpjekje e ardhshme për ndryshimin apo heqjen e nenit 162 do të kërkonte sërish të njëjtën mbështetje të posaçme. Edhe nëse do të kishte konsensus të gjerë politik, do të nevojiteshin së paku 14 vota nga 20 deputetët e komuniteteve joshumicë. Pa këtë shumicë, ndryshimi kushtetues nuk mund të miratohej.

Duke trajtuar organizimin e gjykatës dhe mundësitë e ankimit, Lloga nënvizon se neni 162 i vendos Dhoma e Specializuar "në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës". Struktura, funksionimi dhe juridiksioni i tyre përcaktohen nga ky nen dhe nga Ligji nr. 05/L-053.

Ky ligj nuk parashikon vetëm një trup gjykues të shkallës së parë, por një sistem të plotë që përbëhet nga Dhoma e Gjykatës Themelore, Dhoma e Gjykatës së Apelit, Dhoma e Gjykatës Supreme dhe Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese për çështjet kushtetuese.

Për këtë arsye, sipas Llogës, vendimi i shkallës së parë nuk nënkupton mbylljen e procesit. Legjislacioni lejon paraqitjen e ankesës dhe përcakton kompetencat e Panelit të Gjykatës së Apelit. Në rrethanat që parashikon ligji, mund të përdoren edhe kompetencat e Gjykatës Supreme dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike.

Për çështjet që tashmë po trajtohen brenda këtij sistemi, rruga kryesore procedurale kalon nëpërmjet mjeteve të ankimit, veçanërisht Apelit. Në këtë fazë, rëndësi kanë provat, kriteri i përgjegjësisë individuale, gabimet e mundshme faktike dhe juridike, arsyetimi i aktgjykimit, si dhe respektimi i të drejtave të mbrojtjes.

Në analizë trajtohen gjithashtu detyrimet e Gjykatës ndaj shtetit të Kosovës dhe përgjegjësitë e Kosovës ndaj këtij mekanizmi. Lloga thekson se arkitektura e Dhomave të Specializuara nuk mbështetet vetëm në aktet ligjore dhe kushtetuese të Kosovës, por edhe në marrëveshjet e zotimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës me Bashkimin Evropian.

Më 14 prill 2014, Kosova dhe Bashkimi Evropian nënshkruan marrëveshjen për vendosjen e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX. Ky dokument krijoi bazën për praninë dhe ushtrimin e kompetencave të misionit në Kosovë, ndërsa më pas u plotësua dhe u zgjat përmes marrëveshjeve të tjera.

Po më 14 prill 2014 u nënshkrua edhe marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për pjesëmarrjen e Kosovës në punën e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Nga këndvështrimi juridik, ajo përcaktoi bazën e bashkëpunimit për funksionimin e mekanizmit, duke përfshirë përkrahjen administrative, financiare dhe teknike.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Bashkimi Evropian mori përsipër të mbështeste veprimtarinë e Dhomave të Specializuara, kurse Republika e Kosovës u zotua të siguronte kushtet institucionale dhe juridike të nevojshme për zbatimin e mandatit të tyre. Këto marrëveshje nuk zëvendësuan Kushtetutën e Kosovës, por u përfshinë në kornizën e bashkëpunimit ndërkombëtar mbi të cilën u mbështet puna e institucionit.

Më 15 dhjetor 2015, Këshilli i Bashkimit Evropian miratoi vendimin për themelimin e Zyrës së BE-së për Mbështetjen e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Përmes këtij vendimi u mundësuan financimi dhe mbështetja nga buxheti i përbashkët i BE-së. Mandati dhe financimi u zgjatën më vonë me vendime të tjera të Këshillit të BE-së.

Për rrjedhojë, Lloga vlerëson se çdo nismë për ta ndryshuar këtë mekanizëm duhet të marrë në konsideratë jo vetëm procedurën kushtetuese të Kosovës, por edhe pasojat politike dhe juridike që lidhen me marrëveshjet dhe zotimet ndërkombëtare.

Në përfundim, ai thotë se ndryshimi i strukturës kushtetuese të Dhomave të Specializuara është teorikisht i realizueshëm, por nga aspekti politik dhe ligjor mbetet jashtëzakonisht i vështirë, ose pothuajse i pamundur. Arsyja është kërkesa për shumicën e kualifikuar prej dy të tretave, duke përfshirë votat e deputetëve të komuniteteve joshumicë dhe minimumi edhe votat e 4 deputetëve serbë.

Për këtë shkak, sipas Llogës, diskutimi publik në Kosovë duhet të largohet nga përpjekjet për zhbërjen e Gjykatës dhe të përqendrohet te sfidat e mbrojtjes juridike që po zhvillohen brenda sistemit aktual të Dhomave të Specializuara.



Liria ka Emër" paralajmëron vazhdimin e protestës sonte në Prishtinë



Imzot Dodë Gjergji reagon për vendimin ndaj ish-drejtesve të UÇK-së:...



Altin Krasniqi: Dënimi me 25 vjet është shumë i rëndë, babai mund të mo...



Berisha kërkon seancë të jashtëzakonshme të Kuvendit pas vendimit të...



Jashari kërkon anëtarësimin e Kosovës me të drejta të plota në Kartë...



FSK-ja zhvillon ushtrimin "Valor Shield 2026" me ushtritë e SHBA-së,...



Përplekja për grusht shteti do të dështojë", Naim Miftari reagon ndaj sulme...



Berishaj pas aktgjykimit në Hagë: Kosova s'do të lejojë përdorimin e verdiktit...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.